

University of Business and Technology in Kosovo

UBT Knowledge Center

Theses and Dissertations

Student Work

Spring 4-2013

RËNDËSIA E ANTARËSIMIT TË KOSOVËS NË FONDIN MONETAR NDËRKOMBETAR

Shend Abdullahu

Follow this and additional works at: <https://knowledgecenter.ubt-uni.net/etd>



Part of the **Business Commons**



Universiteti për Biznes dhe Teknologji
Departamenti për Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi

Punim Seminarik
2009/2010

Shend Abdullahu

RËNDËSIA E ANTARËSIMIT TË KOSOVËS NË FONDIN MONETAR
NDËRKOMBETAR

Phd.Cand Bukurie Imeri-Jusufi

Prill/2013

Ky punim është përpiluar dhe dorëzuar në përmbushjen e kërkesave të pjesshme
për Shkallën Bachelor

ABSTRAKTI

Në këtë studim seminarik kemi diskutuar për Fondin Monetar Ndërkombtar që u krijua rreth viteve të 50 ajo u krijua vetëm për një që ta krijoj një kornizë të ekonomis dhe të ndihmoj vendet që janë në transicion me këshilla ekonomike dhe këshilla financiare. Është një organizatë ndërkombëtare e 188 vendeve me seli në Ëashington, D.C.. Qëllimi primar i themelimit të fondit monetarë ndërkombëtarë ka qenë që të krijohet një bashkëpunim monetarë mes vendeve, stabilitet monetar në këmbim dhe marrveshje të rregullta të këmbimit monetarë për të shpejtuar rritjen ekonomike, për të ngritur nivelin e punësimit dmth zvoglimin e nivelit të papunësisë dhe për të krijuar asistencë të përkohëshme të shteteve të varfëra për të balancuar sistemin pagesorë.

Kur një vend anëtarsohet ne FMN, ai pranon ti nënshtrohet politikave të saj ekonomike dhe financiare në shqyrtimin e bashkësisë ndërkombëtare. FMN gjithashtu angazhohet për ndjekjen e politikave të favorshme për rritjen ekonomike dhe për stabilitetin e çmimeve, angazhohet për tu shmangur manipulimeve me normat e këmbimit që normat të jenë konkruuese dhe të drejta dhe për tu siguruar të dhëna rreth ekonomisë së vendeve antare.

Kur një vend anëtarsohet ne FMN, ai pranon ti nënshtrohet politikave të saj ekonomike dhe financiare në shqyrtimin e bashkësisë ndërkombëtare. FMN gjithashtu angazhohet për ndjekjen e politikave të favorshme për rritjen ekonomike dhe për stabilitetin e çmimeve, angazhohet për tu shmangur manipulimeve me normat e këmbimit që normat të jenë konkruuese dhe të drejta dhe për tu siguruar të dhëna rreth ekonomisë së vendeve antare. FMN monitoron rregullishtë ekonomitë dhe ofron këshilla lidhur me politikat dhe qëllimet për të identifikuar dobësit që janë shkaktuar që të mos e çojë në paqëndrueshmëri financiare apo ekonomike. Ky proces quhet mbikqyrje.

Një nga përgjegjësitë kryesore të FMN është tu japë hua vendeve me probleme në bilancin e pagesave. Kjo asistencë financiare i mundëson vendeve të rindërtojnë rezervat e tyre ndërkombëtare; të stabilizojnë valutat e tyre; të vazhdojnë të paguajnë për importet e tyre dhe të përtërijnë kushtet për rritje të mirë ekonomike. Ndryshe nga bankat, FMN nuk jep hua për projekte specifike

Asistenca teknike e FMN-së mbështet zhvillimin e resurseve produktive të vendeve anëtare duke i ndihmuar ato të menaxhojnë në mënyrë efektive politikat e tyre ekonomike dhe financiare. FMN i ndihmon këto vende të forcojnë kapacitetin e tyre me anë të burimeve njerëzore dhe insitucionale, dhe të zhvillojnë politika të sakta makroekonomike, financiare dhe strukturale.

Permbajtja

1.Hyrja	1
2.Fondi Monetar Ndërkombëtar.....	2
3.Mbikqyrja e FMN	3
3.1.Përse është e rëndësishme mbikqyrja e FMN	3
3.2.Zhvillimi i mbikqyrjes së FMN dhe roli i saj sot.....	4
3.3.Vendimi i 2007 mbi Mbikqyrjen Dy-palëshe	4
3.4.Forcimi i Praktikës së Mbikqyrjes	5
3.5.Mbikqyrja Shumëpalëshe.....	5
4.HUADHENIA E FMN	6
4.1.Procesi i huadhënies së FMN.....	6
5.ASISTENCA TEKNIKE	7
5.1.Përfituesit e asistencës teknike.....	7
5.3.Integrimi i asistencës teknike me mbikqyrjen dhe huadhënien	8
5.4.Në çfarë fushash ofron FMN asistencë teknike	8
5.5.Si ofrohet asistenca teknike.....	9
5.6.Si paguhet asistenca teknike	9
7. PERFUNDIMI: INFORMATA TJERA MBI ANETARESINE DHE PERPARPARESIT E ANETARSIMIT	12
7.1. Procedurat	13
7.2. Parakushtet.....	13
7.3.Aplikimi formal dhe kuota e antarsimit	14
7.4.Komisioni ad-hoc.....	14
7.5.Votimi	15
Figura. 1	15
7.6.Hapat e ardhshëm – rekomandimet.....	16
8.METODOLOGJIA	17

1.Hyrja

Fondi Monetar Ndërkombtar u themelua më shumë se 60 vite më parë në përfundim të Luftës së Dytë Botërore. Themeluesit qëllim kryesorë kishin ndërtimin e një kornize për bashkëpunim ekonomik për tu shmangur prej një përsëritje të politikave ekonomike të shkatërrimit . Depresioni i madh i viteve të 30 që krijoi konfliktë global. Që atëherë bota ka ndryshuar në mënyrë drastike, duke sjellë prosperitet të gjerë dhe heqjen e miliona njerëzve nga varfëria, vecanërisht Azin. Në shumë mënyra qëllimi kryesor i FMN – është të sigurojë një stabilitetë financiarë. Edhe sot janë qëllimet e njëjta që kur u themeluar. Më konkretisht, FMN – ja vazhdon të:

- Të sigurojë një forum për bashkëpunim për zhgjidhjen e problemeve monetare nderkombtare
- Të lehtësojë rritjen e tregtisë ndërkombëtare, duke krijuar vende të punës rritje ekonomike dhe uljen e varfërisë
- Të promovojë stabilitetin e kursit të këmbimit dhe të krijoj një sistem të hapur të pagesave ndërkombëtare dhe
- Të jep hua vendeve kur është e nevojshme në baza të përkohshme dhe nën masa mbrojtëse adekuate, për të ndihmuar ata të adresojnë problemet e bilancit të pagesave

Përshtatja në FMN

FMN – ja ka evoluar së bashku me ekonominë globale gjatë 65 vjetëve të historisë së saj, duke e mbajturë rolin e saj qendror në kuadër të arkitekturës financiare nderkombëtare.

Si ekonomia botërore që lufton për të rivendosur rritjen dhe vendet e punës pas krizës më të madhe Depresioni i Madh, FMN është shfaqur si një institucion shumë ndryshe. Gjatë krizës FMN I mobilizoi shumë vende antare të saj. FMN rriti kreditimin, duke e përdorur përvojën e saj për këshilla politike, duke koordinuar politikat globale, dhe duke reformuar mënyrën e vendim marrjes. Me fjalë tjera FMN mendon më shumë për vendet antare të saj.

2.Fondi Monetar Ndërkombëtar

Është një organizatë ndërkombëtare e 188 vendeve me seli në Ëashington, D.C.. Qëllimi primarë i themelimit të fondit monetarë ndërkombëtarë ka qenë që të krijohet një bashkëpunim monetarë mes vendeve, stabilitet monetar në këmbim dhe marrveshje të rregullta të këmbimit monetarë për të shpejtuar rritjen ekonomike, për të ngritur nivelin e punësimit dmth zvoglimin e nivelit të papunësisë dhe për të krijuar asistencë të përkohëshme të shteteve të varfëra për të balancuar sistemin pagesorë.

FMN – ja është vendosur në mënyrë unike për të ndihmuar qeveritë anëtare që të përfitojnë nga mundësit dhe për ti menaxhuar sfidat e paraqitura nga globalizimi dhe zhvillimi ekonomik në përgjithësi. FMN – ja hulumton trendet globale dhe performancëat ekonomike, dhe nëse vren ndonjë problem ajo alarmon vendet antare të saj, ofron një forum për dialog politik, dhe i këshillon qeverit për të trajtuar vështërsit ekonomike.

FMN – ja këshilla politike dhe financion anëtarët që janë në vështirësi ekonomike dhe gjithashtu punon me vendet në zhvillim për të ndihmuar ata që të arrijn stabilitet makroekonomik dhe për të zvogëluar varfërin , me fjalë tjera FMN i ndihmon vendeve që janë në tranzicion.

Globalizimi ndikon në zgjedhjen e politikave në shumë fusha duke përfshirë punën, tregtinë dhe politikat tatimore. Ndihma për përfitim nga globalizimi duke ju shmangur dobësive të mundshme është një detyrë e rëndësishme e FMN – ës. Kriza globale ekonomike ka treguar se sa vende janë të ndërlidhura ekonomitë e sotme botërore.

Aktivitetet kryesore të FMN – ës:

FMN mbështet anëtarët e saj, duke siguruar

- Këshilla politike për qeveritë dhe bankat qendrore të bazuara në analizën e trendeve ekonomike
- Hulumtime, statistika, parashikime, dhe analiza të tregjeve bazuar në ndjekjen e ekonomive globale, rajonale dhe individuale
- Kredi për të ndihmuar vendet antare për tajkalimin e vështirsive ekonomike
- Kredi për të ndihmuar në luftën kundër varfërisë në vendet në zhvillim dhe
- Asistencë teknike dhe trajnim për të ndihmuar vendet për përmirsimin e menaxhimit të ekonomive të vendit.

3.Mbikqyrja e FMN

Kur një vend anëtarsohet ne FMN, ai pranon ti nënshtrohet politikave të saj ekonomike dhe financiare në shqyrtimin e bashkësisë ndërkombëtare. FMN gjithashtu angazhohet për ndjekjen e politikave të favorshme për rritjen ekonomike dhe për stabilitetin e çmimeve, angazhohet për tu shmangur manipulimeve me normat e këmbimit që normat të jenë konkurruese dhe të drejta dhe për tu siguruar të dhëna rreth ekonomisë së vendeve antare. FMN monitoron rregullishtë ekonomitë dhe ofron këshilla lidhur me politikat dhe qëllimet për të identifikuar dobësit që janë shkaktuar që të mos e çojë në paqëndrueshmëri financiare apo ekonomike. Ky proces quhet mbikqyrje.

Për të promovuar stabilitetin ekonomik global nëpërmjet kooperativeve multilateral, FMN-së i është dhënë një mandat për të mbikqyrur sistemin monetar ndërkombëtar dhe për të monitoruar politikat ekonomike dhe financiare të 185 vendeve anëtare. Mbikqyrja e FMN-së ofron vlerësim të specializuar të zhvillimeve ekonomike dhe financiare globale dhe rajonale . Ajo jep këshilla rreth rreziqeve që i kanosen stabilitetit dhe rritjes ekonomike. Në këtë mënyrë FMN-ja ndihmon sistemin monetar ndërkombëtar që ti shërbejë qëllimit të tij primar duke dhënë një kornizë që lehtëson shkëmbimin e të mirave, shërbimeve dhe kapitalit ndërmjet vendeve dhe të mbajë një rritje ekonomike të mirë.

3.1.Përse është e rëndësishme mbikqyrja e FMN

Në ekonominë e sotme globale, ku politikat ekonomike dhe financiare të një vendi mund të ndikojnë në shumë vende të tjera, bashkëpunimi ndërkombëtar në shkallë globale për të monitoruar dhe influencuar zhvillimet ekonomike është e domosdoshme. Me pjesmarrjen pothuajse universale të 180 vendeve, mbikqyrja e FMN përbën mekanizmin e duhur për këtë bashkëpunim. Mbikqyrja efektive ndihmon në një sistem monetar ndërkombëtar të qëndrueshëm dhe bën të mundur një rritje ekonomike të qëndrueshme me anë të proceseve bashkë-përforcues që vijnë: mbikqyrja shumë-palëshe, ose vështrimi i ekonomisë botërore në tërësi; dhe mbikqyrja dy-palëshe e cila përfshin këshillime për politikat e çdo anëtari individual për të promovuar stabilitet të jashtëm dhe të brendshëm (duke përfshirë edhe rritjen); analizën e efekteve ekonomike nga një vend në tjetrin; dhe eksperiencën e 180 vendeve anëtare.

3.2.Zhvillimi i mbikqyrjes së FMN dhe roli i saj sot

Mbikqyrja, në formën që ka sot, u vendos nga Artikulli IV i Artikujve të Marrëveshjes të FMN në sajë të rishikimit që iu bë në fundin e viteve 70 pas dështimit të sistemit të kurseve të këmbimit fikse Bretton Woods. Sipas Artikullit IV, vendet anëtare marrin përsipër të bashkëpunojnë me FMN-në dhe me njëri-tjetrin për të promovuar stabilitetin e sistemit global të kurseve të këmbimit. Në vecanti, ata duhet ti përmbahen në bërjën e politikave të tyre ekonomike të brëndshme dhe të jashtme, një kodi sjelljeje të caktuar. FMN-ja ka për detyrë të: (i) monitorojë sistemin monetar ndërkombëtar për të siguruar operimin e tij efektiv, dhe (ii) të sigurohet që politikat e çdo vendi anëtar i përmbahen detyrimeve. Për tu siguruar që mbikqyrja të zhvillohet dhe të mbetet efektive në ekonominë e globalizuar të shekullit 21, FMN-ja po implementon një Strategji Afat-Mesme.

3.3.Vendimi i 2007 mbi Mbikqyrjen Dy-palëshe

Në qershor 2007, korniza e politikave mbikqyrëse pati një ndryshim themelor, të parin që nga 1970, me anë të Vendimit mbi Mbikqyrjen Dy-palëshe të Politikave të Anëtarëve, i cili edhe kodifikoi praktikat më të mira. Detajet kryesore të Vendimit janë që ai qartëson që:

- mbikqyrja e një vendi duhet të fokusohet në konstatimin nëse politikat e vendit promovojnë stabilitetin e jashtëm. Kjo do të thotë që mbikqyrja duhet të fokusohet kryesisht në kurset e shkëmbimit valutor, në politikat monetare, fiskale dhe financiare dhe në identifikimin e rreziqeve dhe pikave të dobta;
- çfarë është dhe nuk është e pranueshme për komunitetin ndërkombëtar në faktin se si vendet aplikojnë politikat e kurseve të këmbimit; dhe
- që mbikqyrja është një proces bashkëpunues midis Fondit dhe anëtarëve të tij, që merr parasysh rrethanat specifike të vendeve dhe që ka perspektivë shumë-palëshe dhe afat-mesme.

3.4.Forcimi i Praktikës së Mbikqyrjes

Cilësia e analizës së FMN-së përmirësohet në mënyrë konstante, për të siguruar që FMN-ja të ofrojë këshillat më të mira anëtarëve të saj. Në kuadër të Vendimit të Mbikqyrjes, një prioritet është përmirësimi i vlerësimeve të kurseve të këmbimit. Gjithashtu, edhe problemet e sektorit financiar po mbulohen mirë nga mbikqyrja e FMN-së me anë të mjeteve analitike për të integruar sektorin financiar dhe tregjet e kapitalit në një kuadër të vetëm makroekonomik. Për shkak se mbikqyrja duhet të evoluojë bashkë me ekonominë globale, FMN-ja i rishikon herë pas here politikat dhe praktikat e saj në këto fusha.

3.5.Mbikqyrja Shumëpalëshe

FMN vazhdimisht rishikon tendencat globale dhe rajonale. Instrumentet kyç për mbikqyrjen globale dhe lokale janë dy publikimet gjysem-vjecare, Vështrim në Ekonominë Botërore dhe Raporti i Stabilitetit Financiar Global, i pari i fokusuar në ekonominë botërore në tërësi dhe i fundit në sektorin financiar dhe në tregjet e kapitalit.Për të përmirësuar më tej mbikqyrjen lokale,po implementohet një paketë masash që përfshijnë ndryshime organizative, kërkime dhe diskutime të politikave.Në vecanti, Raporte mbi Ekonominë Rajonale po publikohen cdo vit apo cdo gjashtë muaj për katër rajonë të mëdha.

4.HUADHENIA E FMN

Një nga përgjegjësitë kryesore të FMN është tu japë hua vendeve me probleme në bilancin e pagesave. Kjo asistencë financiare i mundëson vendeve të rindërtojnë rezervat e tyre ndërkombëtare; të stabilizojnë valutat e tyre; të vazhdojnë të paguajnë për importet e tyre dhe të përtërijnë kushtet për rritje të mirë ekonomike. Ndryshe nga bankat, FMN nuk jep hua për projekte specifike

Një vend në vështirësi të rënda financiare, që është i paaftë për të paguar faturat e saj ndërkombëtare, dhe paraqet probleme potenciale për stabilitetin e sistemit financiar ndërkombëtar, FMN u krijua për të mbrojtur. Cdo vend anëtar pa marr parasysh të ardhurat e vendit ai mund të kërkojë financim nga FMN në qoftë se nuk mundet të gjej financim të mjaftueshëm me kushte të volitshme në tregjet e kapitalit për të bërë pagesat ndërkombëtare të saj dhe për të ruajtur në nivel të lartë rezervat.

Kreditë e FMN janë menduar për të ndihmuar vendet anëtare për të trajtuar problemet e bilancit të pagesave, stabilizimin e ekonomive të ture dhe rivendosjen e rritjes së qëndrueshme ekonomike. Kriza globale financiare ka theksuar nevojën për rrjetën globale të efektshme të sigurisë financiare për të ndihmuar vendet të përballen me goditje negative. Një objektiv kyç i FMN – është për reformat e kreditimit ka qenë arsyeja për të plotësuar zgjidhjen e krizës, FMN me mjetet efektive për parandalimin e krizave.

FMN – ja nuk është një bankë zhvillimore dhe ndryshe nga Banka Botërore dhe agjencitë të tjera të zhvillimit ajo nuk financon projekte.

4.1.Procesi i huadhënies së FMN

Me kërkesë nga një vend anëtar, huaja nga FMN jepet nën një “rregullim” që specifikon politikat dhe masat që vendi ka pranuar të ndërmarrë për të rregulluar problemet e tij të bilancit të pagesave. Programi ekonomik formulohet nga vendi nën konsultën e FMN-së dhe i paraqitet Bordit Drejtues të Fondit me anë të një “Letre të Qëllimeve”. Pasi aprovohet nga Bordi, huaja jepet pjesë pjesë, në bazë të zbatimit të programit.

5.ASISTENCA TEKNIKE

Asistenca teknike e FMN-së mbështet zhvillimin e resurseve produktive të vendeve anëtare duke i ndihmuar ato të menaxhojnë në mënyrë efektive politikën e tyre ekonomike dhe financiare. FMN i ndihmon këto vende të forcojnë kapacitetin e tyre me anë të burimeve njerëzore dhe insitucionale, dhe të zhvillojnë politika të sakta makroekonomike, financiare dhe strukturale.

Asistenca teknike e FMN –ës është duke ofruar asistencë teknike dhe trajnim në një gamë të gjerë të fushave të ndryshme, të tilla si bankingu qendror, monetare dhe politikën e kursit të këmbimit, politikën dhe administrimin tatimorë, dhe statistika zyrtare. Objektivi i FMN –ës është që të ndihmojë në përmirësimin e hartimit dhe zbatimit e politikave ekonomike të anëtarëve, bankat qendrore dhe agjencit statistikore. FMN –ja jep edhe këshilla për vendet që kanë për të rivendosur institucionet qeveritare pas trazirave të rënda civile apo lufta.

Në vitin 2008, FMN –ja nisi një përpjekje ambicioze për reforma për të rritur ndikimin e ndihmës së saj teknike. Reformat theksojnë prioritet të mirë, matjen e performancës, etj.

5.1.Përfituesit e asistencës teknike

Asistenca teknike është një nga përfitimet e anëtarësimit në FMN. Zakonisht jepet falas për çdo vend anëtar që e kërkon. Rreth 90% e asistencës teknike të FMN shkon për vendet me të ardhura të ulta ose mesatare. Vendet e sapo dala nga konfliktet janë gjithashtu përfituese. Përveç përfitimeve të menjëhershme nga vendet, asistenca teknike ndihmon stabilitetin ekonomik global, duke ndihmuar vende individuale të minimizojnë dobësitë e tyre ekonomike. Më tej, asistenca teknike që i jepet vendeve me industrializim të zhvilluar apo në zhvillim në fusha të caktuara të rëndësishme, e mban FMN-në në korrent me inovacionet dhe rreziqet që i kanosen ekonomisë ndërkombëtare.

Asistenca teknike është një nga aktivitetet kryesore të FMN –ës. Ajo është e përqendruar në zona kritike të politikës makroekonomike, ku FMN ka përparësi më të madhe krahasuese. Falë antarsimit të saj universal, Programi teknik i FMN –ës ndihmon për tu informuar nga përvojat dhe njohuritë e fituara nëpër rajone të ndryshme dhe vende në nivele të ndryshme të zhvillimit.

Rreth 80% e asistencës teknike e FMN –ës shkon në vende me të ardhura të ulta dhe mesatare.

5.2.Llojet e asistencës teknike

Asistenca teknike e FMN –ës merr forma të ndryshme, sipas nevojave duke filluar nga ndërtimi i kapaciteteve dhe mbështetjen e politikave të vendeve që janë në krizë financiare. Asistenca teknike është në mënyra të ndryshme. Stafi i FMN mund të viziton vendet anëtare për të këshilluar qeverit qendrore dhe zyrtarët e bankave për çështje të veçanta. Asistenca teknike është e integruar me axhendat e reformave të vendit, si dhe mbikqyrjen e FMN –ës dhe operacioneve të huadhënies. FMN poashtu ofron kurse dhe trajnime për zyrtarët e qeverisë qendrore dhe bankave të vendeve anëtare në selinë e saj në Uashington dhe në qendrat rajonale të trajnimit në Austri, Brazil etj.

5.3.Integrimi i asistencës teknike me mbikqyrjen dhe huadhënien

Asistenca teknike ndihmon në efektivitetin e programeve të mbikqyrjes dhe huadhënies të FMN, dhe është një zgjatim i rëndësishëm i këtyre dy funksioneve kryesore. Asistenca teknike e specializuar nga ana e FMN-së ndihmon në rritjen e kapacitetit të vendeve në bërjen e politikave efektive, duke përfshirë suportin për mbikqyrjen dhe huadhënien. Nga ana tjetër, mbikqyrja dhe huadhënia rezultojnë në politika dhe eksperiencë që e informojnë dhe e forcojnë më tepër asistencën teknike të FMN sipas teknikave më të mira ndërkombëtare. Duke parë këto lidhje, arritja e një integrimi më të madh midis asistencës teknike, mbikqyrjes dhe operacioneve të huadhënies është një prioritet kyç për FMN.

5.4.Në çfarë fushash ofron FMN asistencë teknike

FMN ofron asistencë teknike në fushat e saj kryesore të ekspertizës: në politikat makroekonomike, në politikat e taksimit dhe administrimin e të ardhurave nga tatimet, në menaxhimin e shpenzimeve, në politikat monetare, në sistemin e kurseve të këmbimit dhe në statistikat financiare dhe makroekonomike. Në vecanti, përpjekjet e viteve të fundit në forcimin e sistemit financiar ndërkombëtar kanë shtuar kërkesën për asistencë teknike nga ana e FMN.Në të

njëjtën kohë, ka një kërkesë në rritje për asistencë teknike nga ana e vendeve me të ardhura të ulta për të ndërtuar dhe implementuar programe për uljen e varfërisë dhe për zhvillimin e rritjes ekonomike si dhe për të ndihmuar vendet e varfra me borxhe të shumta të menaxhojnë programet për reduktimin e borxheve. FMN gjithashtu ofron asistencë teknike për çështjet e lidhura me tregtinë dhe synon të asistojë vendet me të ardhura të ulta në zgjerimin e pjesmarrjes së tyre në ekonominë globale.

5.5.Si ofrohet asistenca teknike

Vendi përfitues është i përfshirë tërësisht në procesin e asistencës teknike, që me identifikimin e nevojave, me implementimin, monitorimin dhe vlerësimin. FMN jep asistencë teknike në mënyra të ndryshme. Në varësi të natyrës së çështjes, supporti shpesh ofrohet me anën e stafëve misionarë të dërguar nga qendra për një periudhë të kufizuar kohe, ose me anë të vendosjes së ekspertëve dhe/ose këshilltarëve rezidentë për periudha që variojnë nga disa javë deri në disa vjet. Gjithashtu asistenca mund të jepet edhe në formën e studimeve teknike apo diagnostifikuese, kurseve të trajnimit, seminareve dhe suportit “on-line”.

FMN ka përshtatur në shkallë rritëse një sistem rajonal për ofrimin e asistencës dhe trajnimit teknik. Ajo operon në gjashtë qendra rajonale të asistencës teknike: në Paqësor; në Karaibe; në Afriken Lindore, Perëndimore dhe Qendrore dhe në Lindjen e Mesme. Përveç trajnimit që ofrohet në Insitutin e FMN në Ëashington D.C, FMN gjithashtu ofron kurse dhe seminare për zyrtarë të vendeve me anë të një rrjeti prej shtatë Insitutesh rajonale trajnimi .

5.6.Si paguhet asistenca teknike

Asistenca teknike llogaritet si një e pesëdhjeta e buxhetit operativ të FMN. Ajo financohet nga burime të brendshme dhe të jashtme, këto të fundit përfshijnë fondet nga donatorë dy-palësh dhe shumë-palësh. Ky kooperim dhe ndarje burimesh me donatorët e jashtëm ka disa përfitime: ai shton burimet e brendshme të disponueshme për asistencë teknike, ndihmon në mënjanimin e këshillave të dublikuara nga donatorë të tjerë dhe forcon bashkëpunimin me donatorët dhe ofruesit e tjerë të asistencës.

Donatorët dy-palësh të asistencës teknike të FMN përfshijnë Australinë, Austrinë, Brazilin, Kanadanë, Kinën, Danimarkën, Finlandën, Francën, Gjermaninë, Indinë, Irlandën, Italinë, Japoninë, Republikën e Koresë, Luksemburgun, Hollandën, Zelandën e Re, Norvegjinë, Portugalinë, Rusinë, Singaporin, Suedinë, Zvicrën, Mbretërinë e Bashkuar dhe Shtetet e Bashkuara. Donatorët shumë-palësh përfshijnë Bankën Afrikane për Zhvillim, Fondin Monetar Arab, Bankën Aziatike për Zhvillim, Komisionin Evropian, Bankën Inter – Amerikane për Zhvillim, Kombet e Bashkuara, Programin për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (UNDP) dhe Bankën Botërore. Në 2007, financimet e jashtme përbënin pothuajse një të pesëdhjetën e buxhetit total për asistencë teknike të FMN.

6.PARTNERITETI ME DONATORET

Donatorët dypalëshe dhe shumëpalëshe po luajnë një rol shumë të rëndësishëm në mundsimin e FMN – ës për ti plotësuar nevojat e vendit në këtë fush. Me kontributet e tyre që financiojnë, rreth dy të tretat e anëtarëve të FMN – ës në terren të asistencës teknike. Partneritet të fort midis vendeve përfituese dhe donator të mundësuar asistencë teknike FMN duhet të zhvillohet mbi bazën e një dialogu gjithëpërfshirës dhe në kuadër të një kornize koherente të zhvillimit.

7. PERFUNDIMI: INFORMATA TJERA MBI ANETARESINE DHE PERPARPARESIT E ANETARSIMIT

Një shteti anëtar në FMN i caktohet kuota, që është proporcionale me nivelin ekonomik të shtetit dhe potencialit që ka ajo ekonomi. Kuota e një anëtari në FMN përcakton:

- Shumën e parapagimit – Kosova duhet të paguajë një shumë parapagimë përputhshme me kuotën;
- Fuqinë votuese; kuota përcakton fuqinë votuese të një shteti (shih tabelën më poshtë)
- Qasjen në financim tek FMN; huamarrja nga këto institucione është ekufizuar;
- Alokimin e të Drejtave Speciale të Tërheqjes (SDR) që përdoret si njësimatëse nga FMN dhe paraqet një shportë të valutave kryesore botërore.

Për qëllime të krahasimit, kuota e Malit të Zi është diku 0.01 për qind e totalit (27.5 milion SDR) dhe ka 525 vota apo 0.02 për qind të totalit. Kuota e Shqipërisë është 0.02 për qind (48.7 milion SDR) dhe ka 737 vota (0.03 për qind e totalit). (Burimi: FMN)

Përveç financimit të kufizuar, përparësitë e anëtarësimit përfshijnë:

- Ndihmë në reformat strukturale me qëllim të zbutjes së varfërisë,
- Fonde për të arritur këto reforma strukturale,
- Informata të besueshme të cilat mund t'ju shkojnë investitorëve përkonominë dhe rrezikun e investimeve në Kosovë, që në fund do të çojë drejt rangimit kreditor të Kosovës;
- Ndihmë në politikat drejt arritjes së stabilitetit makroekonomik dhe fiskal. Më me rëndësi në këtë periudhë është fakti se FMN-ja dhe BB-ja janë dy institucionet më të rëndësishme financiare dhe anëtarësia në këto institucione, përveç përparësive zhvillimore dhe financiare, do të forconte legjitimitetin e Kosovës si shtet i pavarur.

Prandaj, në qoftë se një masë kritike e shteteve aksionare në FMN dhe BB embështesin pranimin e anëtares së re, Kosova mund të bëhet anëtare e këtyre dy institucioneve me prestigj. Megjithatë, procesi i anëtarësimit nuk është i lehtë dhe kërkon shumë punë nga shteti që aplikon

për anëtarësim. Këtë e kemi parë ngapërvoja e disa shteteve të reja në botë që janë bërë anëtarë në këto institucione sëfundit, siç janë Timori Lindor dhe Mali i Zi. Mali i Zi u bë anëtare e Fondit Monetar Ndërkombëtar në janar 2007, shtatë muaj pas shpalljes së pavarësisë nga autoritetet malazeze, edhe pse ata i patën bërë shumicën e përgatitjeve para aktit të shpalljes. Prandaj është shumë me rëndësi që qeveria e Kosovës të iniciojë procesin e anëtarësimit në këto dy institucione posa ta shpall pavarësinë. Borxhi potencial i jashtëm (gjysma e të cilit është ndaj Bankës Botërore) është diskutuar gjatë negociatave për status në Vjenë. Autoritetet e Kosovës kanë shprehur gatishmërinë për të marrë përsipër borxhin që potencialisht i takon Kosovës, pas shqyrtimit të dokumentacionit origjinal të borxhit. Autoritetet serbe që momentalisht po e kthejnë atë borxh, nuk e kanë siguruar dokumentacionin origjinal në lidhje me borxhin e Kosovës ndaj Bankës Botërore. Kjo analizë nuk ka për qëllim që të ofrojë informata në lidhje me borxhin e Kosovës ndaj Bankës Botërore. Po ashtu kjo analizë nuk merr ndonjë pozicion në lidhje me këtë çështje. Qëllimi i kësaj analize është vetëdijësimi sa më i madh mbi anëtarësimin në INF dhe për të dhënë informacione për hapat e parë në këtë procedurë.

7.1. Procedurat

Një shtet duhet të jetë anëtar i Fondit Monetar Ndërkombëtar para se të bëhet anëtar i Bankës Botërore. Edhe pse anëtarësimi në bankë Botërore po ashtu përfshin shumëpunë procedurale, prioriteti i parë duhet të jetë fillimi i negociatave me FMN-në.

Edhe pse një shtet duhet të bëhet anëtar i FMN-së para se të bëhet anëtar i BB-së, shumë procedura të anëtarësimit mund të kryhen paralelisht. P

7.2. Parakushtet

Anëtarësia në FMN është në të njëjtën kohë pjesa më e rëndësishme dhe pjesa më evështirë e procesit të anëtarësimit. Për tu bërë anëtar i FMN-së, duhet të përmbushen këto kritere:

1. Aplikuesi duhet të jetë shtet – FMN nuk kërkon si parakusht anëtarësimin në OKB
2. Aplikuesi duhet të jetë në kontroll të punëve të jashtme – Pas shpalljes së pavarësisë, autoritetet e Kosovës do të jenë në kontroll të punëve të jashtme.

3. Aplikuesi duhet të ketë mundësinë dhe duhet të jetë gati t'i marrë obligimet e anëtarësimit- Kjo përfshin ndryshimin në legjislacion të shtetit aplikues, ku Kosova do tëndërmerrte obligimet e anëtarësimit. Për shembull, Mali i Zi në tetor 2007 miratoiligjin për anëtarësimin e Malit të Zi në FMN dhe institucione të tjera financiare, sipas të cilit Mali i Zi pranoi anëtarësimin në institucionet financiare me të gjitha obligimet që i sjell anëtarësimi në marrëveshjet e tyre, duke përcaktuar se Ministria e Financave do të jetë agjenti fiskal i Republikës së Malit të Zi në Bankën Botërore, ndërsa Banka Qendrore e Malit të Zi u caktua agjent fiskal i Malit të Zi në FMN (Burimi: Qeveria e Malit të Zi). Legjislacioni do ta lejonte aplikuesin të nënshkruajë nene të marrëveshjesme FMN-në. Përveç legjislacionit, zotimet do të përfshinin zotimin për të paguar anëtarësimin e caktuar dhe kërkesa të tjera nga nenet e marrëveshjes.

7.3. Aplikimi formal dhe kuota e antarsimit

Pas përmbushjes së të gjitha këtyre kushteve, një shtet duhet të plotësojë aplikacionin për anëtarësim në Fondin Monetar Ndërkombëtar. Pas pranimit të aplikimit, FMN-ja e dërgon një mision special të anëtarësimit në Kosovë për të mbledhur informatat dhe për të përgatitur një dokument vlerësues të ekonomisë së Kosovës. Misioni poashtu rekomandon edhe pjesëmarrjen e shtetit në FMN që bëhet sipas pozitë ekonomike të atij shteti në krahasim me shtetet e tjera. Misioni i anëtarësimit do të kërkojë nga autoritetet e Kosovës mbledhjen e informatave për ekonominë e Kosovës që nga viti 1984. Kjo do të paraqet vështirësi për autoritetet e Kosovës, pasi që informatat mbi ekonominë e Kosovës, posaçërisht gjatë viteve të 90-ta nuk janë në dispozicion shumë lehtë dhe do të kërkonin shumë supozime. Autoritetet e Kosovës dhe FMN-ja duhet të jenë gati për të adresuar çështjen e informatave që nuk ekzistojnë.

7.4. Komisioni ad-hoc

Bordi Ekzekutiv i Fondit Monetar Ndërkombëtar cakton një komision Ad-Hoc, që përbëhet nga 6-8 drejtorë ekzekutiv nga bordi që caktohen sipas rekomandimeve të drejtorit menaxhues. Ky komision është përgjegjës për aprovimin e kuotës si dhe kushteve të tjera të anëtarësimit.

Kryesuesi i këtij komisioni më vonë kontakton shtetin për të parë se a pajtohen me rekomandimet e komisionit.

7.5.Votimi

Në qoftë se ka pajtim, propozimi i dërgohet bordit të guvernatorëve për aprovim. Propozimi kërkon 51 për qind të votave për të marrë aprovimin. Pas aprovimit, shtetet aplikuese kanë gjashtë muaj për të kompletuar legjislacionin. Procesiprocedural i Bankës Botërore mund të bëhet në të njëjtën kohë, pasi që ka shumëprocedura administrative që duhen të kompletohen.











































Fuqia Votuese në FMN			Fuqia Votuese në BB (IBRD)		
Shteti		Kuota	Shteti		Kuota
1	SHBA 	17.09	1	SHBA 	16.38
2	Japonia 	6.13	2	Japonia 	7.86
3	Gjermania 	5.99	3	Gjermania 	4.49
4	Mbretëria e Bashkuar 	4.94	4	Mbretëria e Bashkuar 	4.3
5	Franca 	4.94	5	Franca 	4.3
6	Kina 	3.72	6	Kina 	2.78
7	Italia 	3.25	7	Italia 	2.78
8	Arabia Saudite 	3.21	8	Arabia Saudite 	2.78
9	Kanada 	2.93	9	Kanada 	2.78
10	Federata Ruse 	2.74	10	Federata Ruse 	2.78
11	Holanda 	2.38	11	India 	2.78
12	Belgjika 	2.12	12	Holanda 	2.21
13	India 	1.91	13	Brazili 	2.07
14	Zvicra 	1.59	14	Belgjika 	1.81
15	Australia 	1.49	15	Spanja 	1.74
16	Meksiko 	1.45	16	Zvicra 	1.66
17	Braziki 	1.4	17	Australia 	1.53
18	Spanja 	1.4	18	Irani 	1.48
19	Korea 	1.35	19	Korea 	1.35
20	Venecuela 	1.22	20	Venecuela 	1.27
21	Suedia 	1.1	21	Meksiko 	1.18
Total 21 shtete		72.35	Total 21 shtete		70.31
Të tjerat		27.65	Të tjerat		29.69

Figura. 1

7.6.Hapat e ardhshëm – rekomandimet

Rekomandohet që Qeveria e Kosovës të vazhdojë me hapat në vijim:

- 1) Fillimi i diskutimeve me FMN-në dhe Bankën Botërore për të filluar procesin e anëtarësimit;
- 2) Përgatitja e aplikacionit, menjëherë pasi që Kosova të shpallë pavarësinë;
- 3) Organizimi i një vizite zyrtare të një delegacioni të Kosovës për të takuar FMN-në dhe BB-në, ku qeveria e Kosovës do të njihej më shumë me këto institucione;
- 4) Fillimi i përgatitjes për misionin e anëtarësimit;
- 5) Fillimi i përgatitjes për legjislacionin e nevojshëm të anëtarësimit

7.7. Kosova është bërë pjesë e Fondit Monetar Ndërkombëtar.

Nga 185 vendeve anëtare të këtij institucioni të rëndësishëm, afro 100 prej tyre kanë votuar pro anëtarësimit të Kosovës në Fondin Monetar Ndërkombëtar. Rezultatet e votimit do t'i paraqiten Bordit të Drejtorëve Ekzekutivë, ndërsa pas shqyrtimit të bordit edhe zyrtarishtë do të bëhet i ditur pranimi.

Ministri I Ekonomisë bëri të ditur se anëtarësimi i Kosovës nuk do të ketë drejtpërdrejt pagesa të menjëhershme po Kosova mund të tërheq kredi të buta nga ky institucion.

Kosova nga moment I konfirmimit do të jetë antare e barabartë me të gjitha shtetet tjera në FMN. Ministri i Financave vlerësoi se anëtarësimi I Kosovës në FMN është parakusht për anëtarësim në çdo institucion tjetër financiar ndërkombëtar. Sipas Ministrit anëtarësimi në këtë institucion hap dyert për anëtarësim edhe në Bankën Botërore.

8.METODOLOGJIA

Pasi që tema i përkas anës përshkruese, përpilimi i kësaj teme bazohet kryesisht në të dhënat apo burimet sekondare. Tema u përpilua duke përdorur portale dhe linqe të ndryshme po ashtu edhe artikuj të ndryshëm të analistëve politik. Janë përdorur edhe portale të FMN – es që aty janë të gjitha të dhënat që kërkohen për FMN. Është përdorur portali i GAP institut ky portal ekskluzivisht merret me studime të llojeve të vecanta. Janë përdorur libra të ndryshëm hyrja në ekonomi ndikimi i organizatave nderkombëtare në vendet atare etj.

Referencat:

[a] www.imf.org

[b] www.institutigap.org

[c] http://en.wikipedia.org/wiki/International_Monetary_Fund